




REPUBLICA E KOSOVË
 REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Nr. Prot. 01-1179/13
 Nr. 02
 Data: 19.04.2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 16.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4513/12, për ztr. *Riad Rashiti – Drejtor i Drejtorise për Zhvillim Ekonomik në Komunen e Gjilanit, për shkak se nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për situatë të mundshme të Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4513-12, lidhur dyshimin se Zyrtari i lartë ztr. Riad Rashiti, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ka shfrytëzuar autoritetin dhe ndikimin e tij për të bërë Sigurimin e Automjeteve të KRM “Higjena” tash “Ecohigjiena” në Kompaninë private të sigurimeve “Grawe Elsing”, është trajtuar sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rasti është trajtuar sipas procedurës së paraparë konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051) dhe është konstatuar se gjatë këtij procesi nuk ka pasur situatë të konfliktit të interesit.

Në këtë rast të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, janë trajtuar të gjitha informacionet e pranuar nën numrin e protokollit; DPKI 03-4513/12, pastaj DPKI-03-760/13, dhe DPKI-03-919/13.

Zyrtari i lartë Riad Rashiti në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Gjilanit është emruar me Vendim, 02 nr.28, të datës 23 janar 2012, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, ztr. Qemail Mustafa.

Në fakt ztr. Rashiti na ka informuar (duke i sjellur edhe kopjet) se ekzistojnë dy kontrata të Sigurimit të Automjeteve të Kompanisë publike rajonale "Higjena" te kompania e sigurimeve "Grawe Elsing" që dikur ka qenë e drejtuar nga Riad Rashiti, por, në periudhen kur Ztr. Rashiti nuk ka pas pozitën e zyrtarit të lartë në Komunën e Gjilanit, d.m.th. e para në periudhen prej 23 korrik 2010 deri 23 korrik 2011, dhe e dyta 23 tetor 2011 deri 23 tetor 2012.

Ndërsa lidhur me dyshimin tjetër të shfaqur nga informatori, se Kompania e Sigurimeve "Grawe Elsig" ka bërë sigurimin e automjeteve të Kuvendit Komunal të Gjilanit, ztr. Riad Rashiti në njoftimin që na e ka dërguar (DPKI-03-919/13) ndër të tjera deklaron: "...Kompania Grawe Elsig asnjë herë dhe asnjë lloj sigurimi nuk i ka shitur apo kontraktuar me Komunen e Gjilanit".

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

